

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: “AGE group” Sh.p.k. & “SINANI ING” Sh.p.k. me adresë në Rahovec Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	17.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim, të datës: **15.06.2021**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: “AGE group” Sh.p.k. & “SINANI ING” Sh.p.k. me adresë në Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I AMF – së NË LAGJEN E EPËRME**, me Numër të prokurimit: **623-21-1546-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-009-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: “AGE group” Sh.p.k. & “SINANI ING” Sh.p.k. me adresë në Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I AMF – së NË LAGJEN E EPËRME**, me Numër të prokurimit: **623-21-1546-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-009-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **09.06.2021**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI I AMF – së NË LAGJEN E EPËRME**, me Numër të prokurimit: **623-21-1546-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-009-5-2-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik: “AGE group” Sh.p.k. & “SINANI ING” Sh.p.k. me adresë në Rahovec, me datën: 15.06.2021 si palë e pa kënaqur ndaj Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës: 09.06.2021 ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042, për aktivitetin e prokurimit: NDËRTIMI I AMF – së NË LAGJEN E EPËRME, me Numër të prokurimit: 623-21-1546-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-21-009-5-2-1, duke supozuar se janë shkelur dispozitat e Nenit 1, 6, 7, 59, 39 dhe 41 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues me datë: 17.06.2021 brenda afatit ligjor ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ku ka konstatuar si vijon:

Qëndrojnë arsyet e eliminimit nga Autoriteti Kontraktuese dhe se oferta e Grup i Operatorëve Ekonomik: “AGE group” Sh.p.k. & “SINANI ING” Sh.p.k. me adresë në Rahovec, është e papërgjegjshme administrativisht.

Baza Ligjore të kërkesës

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 61 të LPP -se , ku na keni eliminuar neve nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se: Sipas paragrafit 4 te ncnit 61 te LPP-se, ku thote: Pas marrjes parasysh te infomracioneve dhe sqarimeve të dorezuara nga tenderusi sipas paragrafi 1. le ketij neni, nese autorileli kontraktues vendos se tenderi eshtejo-norma/i ulëti , autorileti kontrakues dote refuzoje tenderin.

Ndërsa më datë 09.06.2021 pas rivlersimit të tenderit keni shkelur prop ligjin B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETI KONTRAKTUES" permes platformes e-prokurimi.rks-gov.net, ku e ka shpallur fitues kompaninë EUROING Sh.p.k. ngase keni shpallur EUROING Sh.p.k.

Më datë 10.06.2021 kemi kërkuar qasje në dokumentacione dhe ju na keni kthyer pergjigjen sot qe me datë 14.06.2021 eshte ditë pushimi ku edhe vet po na e kushtëzoni që këtë projekt duhet t'a marrë kompania EUROING Sh.p.k sipas ligjit të Republikës së Kosovës duhet të jeni të saktë në përgjigjet e juaja për palët e interesuar në këtë projekt, ku ju nuk na keni lënë t'a shohim se kompania EUROING sh.p.k qfar informacione dhe qfar sqarime ka dhënë për pozicionin e rrjetës me cmim 0.20Copa ku është 500% më i lirë se kompanitë tjera dhe si do t'a implementojë këtë projekt me këto cmime.

Ju na keni diskriminuar në këtë projekt ku nuk na keni dhënë sqarime dhe nuk n'a keni dhënë në një ditë pune por në një ditë pushimi me datë 14.06.2021, dhe ne nuk po kemi mundësi të shohim sqarimet e kompanisë të zgjedhur fituese nga ju.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që Kërkesa për qasje nga ana juaj është dorëzuar me datë: 10.06.2021, në ora: 00.27, që me ditë pune i bie data: 11.06.2021, ndërsa përgjigjen nga AK e keni marr po të njëjtën ditë, me datë: 11.06.2021

(e premte), ku është ofruar qasja prej datës: 14.06.2021 (ditë e hënë) me citimin, për çdo ditë pune nga ora: 08:00 h deri ne: 16:00 h.

Edhe pse dita e hënë nuk është punuar, nuk ka qenë festë zyrtare dhe për shkak të afërsisë së Zyrës së Prokurimit, siç ju kemi premtuar kemi mundur dhe tu ju ofrojmë qasje.

Me datë: 15.06.2021 (e martë) keni qenë prezent ne Zyrën e Prokurimit, ku ne prezencë të Zyrtareve tjerë ju kemi ofruar që të keni qasje dhe e keni refuzuar qëllimisht, pra pretendim i juaj ankimor është i pabazuar.

1. Kërkesat për rishqyrtim

Data e dërgimit	Ofertuesi	Përshkrimi	Statusi i pyetjeve	Shkarko pyetjen	Shkarko përgjigjen
11.06.2021 16:01	AGE group SH PK		Paraqitur	Shkarko 	

Pershendetje

2 messages

AGE GROUP <agegroupshpk@gmail.com>
To: prokurimi.rahovec@gmail.com

Thu, Jun 10, 2021 at 12:27 PM

Bashkangjitur keni kërkesen për qasje në dokumentacione

 Jun 10, Doc 1.pdf
91K

Po ashtu ne si Autoritet Kontraktues, me datë: 01.06.2021, me Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, kemi kërkuar sqarime nga Operatori Ekonomik lidhur me disa pozicion me çmim jo-normalisht të ulët, ku Operatori Ekonomik me datë: 02.06.2021, ka kthyer Përgjigje në kërkesë për sqarime shtese lidhur me pozicionet, ku përpos deklaratës bindëse se do të realizon këto pozicionet në teren, duke cekur:

Ne si kompani jemi shumë të organizuar dhe posedojmë makineri, fabrikën për prodhimin e betonit, fabrikën për prodhimin e dyerve dhe dritareve nga pvc dhe alumin si dhe bëjmë edhe disa prodhime të ndryshme që shërbejnë për ndërtimtarë si psh lidhjen dhe salldimin e armatures me makineri etj. Ne si kompani kemi deshmuar në punët cilësore, punët që kemi kryer me afat të caktuar kohor gje që ne si kompani kemi përfunduar shumë projekte me sukses ku ju si komunë keni qenë investitor. Vlen të ceket se kemi disa kontrata me juve si investitor e që janë në proces të siper të ndërtimit.

Prandaj zotohemi se ne do të përfundojmë të gjitha punimet me sukses të këtij projekti konform projektit paramases dhe paralogarise.

P.S. Duhet të merret parasysh se çmimi total i ofruar për të gjitha punimet është çmim serioz dhe konkurrues në tregun e Kosovës.

Po ashtu ka bashkangjitur: Fotografi të stokut.pdf dhe STOQET 2020.pdf, duke cekur:

Me anë të kësaj shkrese po i bashkangjesim disa foto të stokeve të armatures dhe të tjera të cilat i kemi deklaruar në ATK më 31 dhjetor.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ndërsa ne si Operator Ekonomik kemi dorezuar te gjitha dokumentacionet dhe te gjitha kerkesat dhe sqarimet siq jane kerkuar nga ju si Autoritet Kontraktues

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Ju si AK-ja përveç se keni shpallur fitues operatorin ekonomik EUROING Sh.p.k me disa prej cmimeve jasht tregut , e rrezikon edhe dëmtimin e buxhetit të Komunës në vlerë prej 62,488.20 € sepse ne kemi ofertuar me çmim prej 189,781.66 €, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 252,269.86 €.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që në **VENDIM** për Rishqyrtim të Kërkesës, me datë: 26.05.2021, ju kemi cekur se Oferta juaj është e papërgjegjshme me këtë pretendimet:

a. Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që është absurde që të bëhet realizimi i kontratës për pozicione ku diferenca në çmim duke llogaritur mesataren e të gjitha ofertave të përgjegjshme të pranuar dhe ofertës tuaj është nga 126 % deri në 210 % diferenca me çmimin e tregut:

PARAMETRA DHE PARALLOGARIA NDERTIMI I ANF SE NE LAGJEN E EPËRME RAKOVEC						Construmas	EDR SH.P.K.	Grup i Operatorëve Ekonomik KUOTA SH.P.K.; DAR ING SH.P.K.; ENGRUP SH.P.K.; Bashkëpunim Projekt SH.P.K.	"NBT-ING" SH.P.K.	Grup i Operatorëve Ekonomik AGE group SH.P.K.; SHKAR ING SH.P.K.	Mesatarja	Përqendje %	
3. PËRMBËTJE E BE TËRIT						EURO ING SH.P.K.							
Poz.	Përshkrimi i Pozicionit	Mjësia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi njësi me TVSH (€)			
3.1	Furnizimi dhe betonimi i struktura të betonit me beton të ngjeshur C15 Mpa në trashësi d = 4.6 cm me thembra dhe plaka E cila shërben si struktura mbajtëse e armaturës dhe hidroizolimit	m²	18.50	35.00	6.30	41.30	60.00	35.40	50.00	44.04	30.00	89.32	212%
3.2	Furnizimi dhe betonimi i thembrave shtratore me beton të armuar C25-30 Mpa në përmasa përkatëse sipas projektit. Spërtaqja e jashtme e oborrit të ujit të formuar	m²	208.10	45.00	8.45	53.45	60.00	47.30	62.00	60.10	43.00	54.75	176%
3.3	Çelësi dhe betonimi i rregullimit të betonit të armuar C25/30 Mpa	m²	32.00	45.00	8.45	53.45	60.00	50.00	62.00	60.10	43.00	54.55	177%
3.4	Lubim dhe betonimi i struktura me beton të armuar C25/30 në kalëzimet përkatëse sipas projektit	m²	11.40	45.00	8.45	53.45	60.00	50.00	62.00	62.72	43.00	54.57	178%

b. Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që është absurde që të bëhet realizimi i kontratës për pozicione ku diferenca në çmim duke llogaritur mesataren e të gjitha ofertave të përgjegjshme të pranuar dhe ofertës tuaj është 166 %, diferenca me çmimin e tregut:

PARAMASA DHE PARALLOGARIA NDERTIMI I AMF SE NE LAGJEN E EPERNE RANOVEC						Contractor	EBK SLP.J.	Grup i Operativëve Ekonomikë KUOTA SLP.J., DAR ING SLP.J., „ENGRUP SLP.J., Bashkimi Projekt SLP.J.	"HBT-ING" SLP.J.	Grup i Operativëve Ekonomikë AGE group SLP.J., SINAR ING SLP.J.	Mesatarja	Përqindje %
4	PUNET E ARMATURES			EURO ING SLP.J.								
Poz.	Përshkrimi / Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi njësi po TVSH (%)	TVSH ja 10%	Çmimi njësi me TVSH (%)	Çmimi njësi me TVSH (%)	Çmimi njësi me TVSH (%)	Çmimi njësi me TVSH (%)	Çmimi njësi me TVSH (%)	Çmimi njësi me TVSH (%)	
4.1	Shërbim transporti përpara dhe vendosja e ARMATURES ÇBS-400-500 Mpa në llojeve në të gjitha pozicionet sipas logaritme shtete	kg	26 756.00	0.50	0.09	0.59	0.69	0.83	0.83	0.85	0.39	0.65

c. Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që bazuar në pretendimet e lartë përmendura 1 dhe 2, si dhe duke u bazuar se kjo është oferta e vitit 2019 dhe se çmimet në treg vazhdimisht kanë pasuar rritje.

Pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që me datë: 09.06.2021 me Letër standrade për tenderuesin e eliminuar, kemi cekur:

ARSYETIM:

Tenderi i juaj është administrativisht e papërgjegjshme:

- ☐ Sipas paragrafit 4 të nenit 61 të LPP-së, ku thotë: *Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autori i kontraktues do të refuzojë tenderin.*

Prandaj pas marrjes të informacionit dhe sqarimit të dorëzuara nga ana juaj, ne si Autoriteti Kontraktues vendosëm se tenderi juaj është jo-normalisht i ulët, sqarimet e juaj të dorëzuara nga ana juaj nuk janë bindëse për ne si Autoriteti Kontraktues, për pozicionet që janë me çmim jo-normalisht të ulët, duke mos e përshkruar elementet e tenderit përfshirë elementet e materialit, kostot fikse dhe profitet.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Gjithashtu ju si AK nuk e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne jemi OE më i lirë dhe gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që pretendimet tuaja janë të pabazë se ne nuk ju kemi trajtuar në baze të Nenit 7 dhe 59 të LPP-së, sepse vlerësimi i ofertave është bërë në mënyrë të drejtë konform Nenit 59 të LPP-së.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju mundë të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit

Data: 17.06.2021